


Bob Proctor

Jeni lindur të pasur

- pjesë të zgjedhura –



zgjodhi dhe përktheu

Ridvan Bunjaku

|:(|:)

Prishtinë, korrik 2012

NJË DHE I VETMI TI

Çdo fije e veçantë e barit,

Dhe çdo fluskë e borës -

Është krejt pak më ndryshe...

Nuk ka dy të njëjta, e di

Që nga diçka e vogël, si kokrrat e rërës,

Deri te secili yll gjigant

Të gjitha janë bërë duke e pasur KËTË në mendje:

Të jenë pikërisht çka janë!

Sa budallaqe pra, të imitosh -

Sa e padobishme të shtiresh!

Meqë secili nga ne vjen nga një MENDJE

Idetë e të cilës nuk mbarojnë kurrë.

Do të jetë vetëm NJË si UNË

Të tregojë se çka mund të bëjë -

Dhe prandaj edhe ti duhet të ndihesh krenar

Është vetëm NJË si TI.

Këtu fillon çdo gjë

Me ty, o qenie e mrekullueshme

e pakufizuar njerëzore.

James T. Moore

Përmbajtja

NJË DHE I VETMI TI.....	2
PËRMBLEDHJE	4
UNË DHE PARATË	6
SA ËSHTË MJAFT?.....	9
NDËRTUESI I IMAZHEVE	11
LËSHOJE DËSHIRËN DHE LEJOJE ZOTIN	14
PRIT BEGATI	17
LIGJI I LËKUNDJES DHE I TËRHEQJES	20
NDËRMARRËSIT E RREZIKUT	23
TEHU I BRISKUT TË RROJËS	24
MOS MENDO TEPRAPA	26
LIGJI VAKUMOR I MIRËQENIES	28
PËRFUNDIM	29
FILLIMI.....	30
Publikime tjera	31

PËRMBLEDHJE

Principi themelor: "Duhet t'i duam njerëzit, dhe t'i përdorim paratë", dhe jo e kundërta.

Bollëku i madh nuk është ndonjë mëkat, përkundrazi, është obligim i juaji të bëheni të pasur.

Do të duhej ta keni sasinë e parave që ju nevojiten, për t'ua siguruar gjërat që i doni, dhe për të jetuar në stilin që e zgjedhni.

Tërë jeta juaj qeveriset nga imazhet. Do të duhej të jeni të vetëdijshëm me mendjemprehtësi për imazhet që po i ndërtoni në mendje dhe do të duhej të jeni të vetëdijshëm edhe për nevojën e ndërtimit të këtyre imazheve që do t'i prodhojnë rezultatet që do të ju lëvizin përpara dhe përpjetë, drejt destinacionit tuaj të dëshiruar.

Ju jeni, në fakt, bashkë-krijues. Sigurohuni ta rishikoni shpesh se cila është përgjegjësia juaj, në partneritetin tuaj bashkë-krijues.

"Lëshoje dëshirën dhe lejoje Zotin" - Zhvillo besim të fuqishëm të bazuar në kuptim të thellë. Lëshoje lirshëm imazhin tënd, lërja fuqisë brenda teje, ashtu që fuqia vetë të mund të shkojë të punojë dhe të fillojë t'i materializojë rezultatet fizike, si kopje e saktë e imazhit tënd mendor.

"Prit begati" - model mendor që ka fuqi mbresëlënëse.

Nuk ka absolutisht kurrfarë kompensimi kur luajmë 'në të sigurt'. Është esenciale që së pari të dalësh nga zona e rehatisë, para se të fillosh të lëvizësh drejt destinacionit që e ke zgjedhur për vete.

Fituesit e vërtetë në jetë më shpesh janë, sesa s'janë, vetëm dy apo tre për qind më efektivë se sa ata që humbin. Ky dallim quhet 'tehu i briskut të rrojës'. Mund të jeni po aq efektivë sa kushdo për të cilin lexoni apo dëgjoni.

Paralajmëroheni të mos shikoni prapa. "Mos mendoni teprapa". Përndryshe do të vazhdoni t'i merrni rezultatet e njëjta, vit pas viti.

"Ligji Vakumor i Prosperitetit" na tregon t'i çelim të gjitha dyert, që do t'ia mundësojnë të mirës që e kërkojmë të na vijë nga të gjitha anët. Ky nuk është vetëm ligj shpërblyes por edhe vërtet i shijshëm për ta mësuar. Do të të ndihmojë t'i bashkoh idetë tjera, për ta plotësuar pikturën tënde dhe për të arritur sigurt dhe në kohë te destinacioni yt i dëshiruar.

Leximi dhe mbajtja në mend kurrë nuk do ta "bëjë të ndodhë" për ty. Vetëm kuptimi dhe aplikimi i ideve të duhura do t'i prodhojë rezultatet që i dëshiron. Mendo mirë për secilën ide. Ato janë të thjeshta dhe të lehta për t'u kuptuar, por duhet të veprosh sipas tyre.

UNË DHE PARATË

Paratë janë të rëndësishme. Asgjë nuk mund t'i zëvendësojë paratë në arenën në të cilën përdoren!

Paratë janë shërbyese. Gjithmonë kujtoje, paratë janë shërbyese; ti je zotëruesi. Ki kujdes të mos e përmbysësh atë ekuacion, sepse shumë njerëz të inteligjencës së lartë e kanë bërë tashmë këtë, në dëm të madh për ta.

Paratë duhet të qarkullojnë. Ato janë të vlefshme vetëm përderisa përdoren. Posa të nxirren nga qarkullimi, ato bëhen po aq të kota sa "gazetat e vjetra" apo "kanaçet boshe" që janë gjuajtur diku. Të lutem vëreje se kur po sugjeroj se paratë duhet të mbahen në qarkullim, nuk po nënkuptoj se duhet të shpenzohen pa hesap. Është një botë e tërë e dallimit ndërmjet këtyre dy koncepteve dhe nëse nuk e ke gjetur ende se cili është dallimi, do të sugjeroja ta gjesh sa më shpejt që mundesh.

Paramendoje veten me disa nga miqtë e tu. Pastaj, vizualizojë veten duke ua shpallur atyre synimin tënd që të pasurohesh; të paktën të bëhesh mjaft i pasur sa të jetosh në mënyrën që e zgjedh ta jetosh.

Duhet ta kuptosh se njerëzit që janë të pasur kurrë nuk ndihen në siklet kur flitet për paratë. Njerëzit nuk ndihen rehat me paratë sepse i kanë; ata i kanë ato sepse ndihen rehat me to. Me fjalë tjera, një nga arsyet pse njerëzit e pasur kanë para është sepse e kanë zhvilluar atë gjendje të vetëdijes që e quajmë "vetëdije e mirëqenies". Prandaj, nëse duam të tërheqim para kah vetja, duhet të fillojmë ta kultivojmë edhe vetëdijen për mirëqenie. Mënyra më e mirë është të fillosh ta shohësh veten, në syrin tënd të mendjes, tashmë në posedim të sasisë së parave që e dëshiron. Arsyeja për këtë është sepse meqë mendja e nënvetëdijshme nuk mund ta bëjë dallimin ndërmjet posedimit të vërtetë të parave dhe vizualizimit të thjeshtë, së shpejti do të ndihesh shumë rehat me "idenë" e parave. Si rezultat, do të fillosh ta tërheqësh kah vetja.

Nëse vërtet dëshiron ta rritësh dukshëm sasinë e parave që je duke e fituar tash, gjëja e parë që duhet ta bësh është të mësosh t'i kushtosh dukshëm më pak vëmendje asaj se çka po thonë të tjerët përreth teje dhe dukshëm më shumë vëmendje asaj që po e thotë ai "zë i qetë" që flet brenda teje.

Nuk është vështirë për fëmijët e lindur në familjet me pasuri të madhe që të mendojnë mendime të mirëqenies dhe të kenë vetëdije të mirëqenies, meqë ky është i vetmi tip i të menduarit të cilit i janë ekspozuar, që nga lindja. Pra, ata janë kushtëzuar me mirëqenie.

Mirëpo shumica e njerëzve nuk janë lindur në asi lloj ambienti dhe prandaj nuk kanë qenë të rrethuar nga ai tip i të menduarit. Prandaj duhet ta zhvillojmë një kuptim për atë se:

- 1) si jemi kushtëzuar,
- 2) pse po i marrim rezultatet që po i marrim dhe
- 3) si mund ta ndryshojmë mënyrën tonë të mendimit apo kushtëzimin tonë

Ka fuqi reale brenda teje. Nën nivelin e vetëdijes tënde është thesari i madh i mendjes tënde të nënvetëdijshme dhe ajo është pjesa e personalitetit tënd në të cilën duam të ndikojmë përmes mostrave tona të reja të mendimit.

Duhet ta mbash në mend se po jeton njëkohësisht në tri rrafshë të ndryshme të ekzistencës:

- 1) Rrafshi Shpirtëror i Mendimeve (Potenciali Më i lartë)
- 2) Rrafshi Intelektual i Ideve (Potenciali i Mesëm)
- 3) Rrafshi Fizik i Rezultateve (Potenciali më i Ulët)

Pra mundesh thjesht duke e përdorur "natyrën tënde hyjnore" t'i zgjedhësh mendimet (d.m.th. "Paratë janë të mira", "I dua njerëzit dhe i përdori paratë", "Paratë janë shërbyese; unë jam zotëruesi") që do ta ndërtojnë një ide. Në rastin tonë, ideja ndodh të jetë ajo e "Pasurisë së Madhe Personale", apo "Suksesi i Vërtetë Financiar". Dhe duke e mbajtur këtë ide apo pikturë të bukur të suksesit financiar në mendjen tënde, përfundimisht do të mund të shkaktosh që ideja ta manifestojë veten në jetën tënde (d.m.th. në rezultatet e tua).

Duhet të punosh nga një potencial më i lartë kah ai më i ulët. Çka po mendoj me këtë është që të punosh nga -

Mendimet ... (Shpirti)

te

Ideja ... (Intelektualja)

te

Gjëja ... (Fizikja)

në vend se të punosh nga -

Gjëja ... (Fizikja)

te

Mendimet ... (Shpirti)

te

Ideja ... (Intelektualja)

siç ke bërë me gjasë në të kaluarën dhe shumica dërmuese e njerëzve do të vazhdojnë ta bëjnë në të ardhmen. Pra, shumica e njerëzve do ta shikojnë një Rezultat në jetën e tyre dhe pastaj ta lejojnë atë rezultat t'i diktojë Mendimet që do t'i përdorin pastaj për ta ndërtuar Idenë e tyre. Për shembull, nëse e shohin se llogaria e tyre e bankës është e zbrazët (rezultati), ata do të zgjedhin të mendojnë mendime të mungesës apo të humbjes dhe pastaj do t'i përdorin ato mendime për ta ndërtuar idenë e skamjes.

SA ËSHTË MJAFT?

Një pjesë e tërë asaj që e fiton të takon ty ta mbash

Do të duhej ta paguash veten të paktën dhjetë për qind posa t'i fitosh paratë (d.m.th. jo pasi të jenë paguar të gjithë të tjerët). Mund të paguash sigurime me to, dhe pjesa e mbetur pastaj shkon në kursime, deri në kohën kur ke grumbulluar mjaft kapital për ta bërë një investim të mençur. Kjo quhet Llogaria Jote e Sovranitetit Financiar.

Mbaje në mend, nuk e "prek" këtë llogari apo interesin që e nxjerr ajo. Prandaj, brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore, do të provosh progres të mjaftueshëm për ta fituar motivimin dhe inspirimin që të nevojitet për të vazhduar. Për më tepër, njohuria që e ke një "Pronë të menjëhershme", nëse të ndodh çkado, do të të japë edhe më shumë qetësi të mendjes.

Nëse je në borxhe, hape një Llogari të Shlyerjes së Borxheve ku i deponon njëzet për qind të të ardhurave tua. Bëje një listë të kreditorëve tu për ta përcaktuar se çfarë përpjese të këtij njëzet-përqindëshi do ta marrë secili nga ta.

Tash "rrahja shpinën vetes" mirë sepse që nga ky moment, je në rrugën tënde për ta filluar një mënyrë plotësisht të re të jetës!

Ta rishikojmë shpejt e shpejt se çka ke bërë deri tash:

- 1) E ke një pronë të menjëhershme nëse të ndodh çkado
- 2) Ke llogari të kursimeve
- 3) Je duke e paguar veten
- 4) Ke program të rregullt të shlyerjes së borxheve
- 5) I ke 70% të të ardhurave tua për të jetuar me to; për ta mbajtur shtëpinë dhe për argëtim.
- 6) Mendja jote është e qetë për të vazhduar me idetë e mëdha që vijnë në vijim

Që nga ky moment, kurrë mos mendo më "borxh". Kujtoje se çdo gjë është në vendin e vet - prandaj thjesht përqendrohu në llogarinë tënde të kursimeve, dhe shihe teksa rritet. Përsërite - Unë jam i pasur; Paratë janë të mira; I përdori paratë dhe i dua njerëzit.

Njerëzit bien në tri kategori të ndryshme në lidhje me "financat":

1. Pozita në deficit (në borxh),
2. Pozita e rentabilitetit (vetëm duke ia dalë, por pa borxhe)
3. Pozita e tepicës.

Meqë të gjithë jemi "krijesa të shprehisë", rrjedh se fitimi i më shumë parave nuk do ta ndryshonte patjetër pozitën tonë të përgjithshme financiare. Është e rëndësishme vitale që ta dizajnoni edhe një plan të ri financiar apo t'ua dizajnojë dikush - që t'ju detyrojë ta disiplinoni veten - të paktën për një muaj apo dy - deri sa ta formoni shprehinë e re të të jetuarit sipas atij plani të ri.

Mbaje në mend se ndërsa rriten të ardhurat e tua, dhjetë përqindëshi që po e kursen rritet dhe njëzet përqindëshi që shkon në LLSHB rritet, që domethënë se do të mund t'i shlyesh borxhet e tua më shpejt. Për më tepër, pastaj do të mbetesh me 90% të të ardhurave tua me të cilat do të jetosh. (Tashmë po mund të të shoh të ngazëllyer me këtë ide!)

NDËRTUESI I IMAZHEVE

Njohuria për Ndërtimin e Imazheve e eliminon garën nga jeta jote, duke të lëvizur nga rrafshi garues në rrafshin krijues.

Secili është duke e përdorur konceptin e Ndërtimit të Imazheve dhe secili e ka përdorur gjithmonë. Në fakt, gjithçka që ka ardhur në jetën tënde ka ardhur si rezultat direkt i procesit të Ndërtimit të Imazheve.

Ti je Ndërtues i Imazheve

Shumica e religjioneve predikojnë se Zoti është përgjegjës për gjithçka të bërë në këtë botë dhe do të pajtohesh plotësisht me këtë pohim. Mirëpo, si bashkë-krijues, qeniet njerëzore duhet të bartin përgjegjësi për atë se ÇKA bën Zoti në jetët e tyre.

"O njeri i mirë, Zoti të paska bekuar vërtet me një fermë të bukur", i tha një klerik fetar një bujku tepër të vyeshëm.

"Po i Nderuar, ke të drejtë. Zoti më ka bekuar me fermë të bukur, por do të doja ta kishe parë kur e kishte të tërën të veten!"

Çdo gjë që e bëjmë paraprihet nga një imazh. Së pari mendojmë për ta formuar një imazh, pastaj e bëjmë punën.

Jack Nicklaus, golfisti i famshëm botëror, e shpjegon se kurrë nuk e merr shkopin derisa ta ketë një imazh të qartë në ekranin e mendjes së tij, që e tregon saktësisht se si do të fluturojë topi nëpër ajër, si do ta godasë tokën dhe ku do të rrotullohet pas kësaj.

Në librin e mrekullueshëm, "Shkenca e të pasuruarit" (The Science of Getting Rich), autori, Wallace D. Wattles, i referohet "një gjëje që mendon e cila përhapet, depërton dhe i mbush ndërhapësit e universit." Është e vërtetë se mendimet janë kudo dhe se mund të

depërtojmë me mendjen tonë në këtë materie që mendon dhe ta formojmë çfarëdo imazhi që e zgjedhim.

Pra bëhu i vetëdijshëm për këtë të vërtetë dhe depërto në të tash. Përdore për ta formuar një imazh në ekranin e mendjes tënde; shihe veten tashmë në posedim të sasisë së parave që i do, për të t'i ofruar gjërat që të nevojiten, për të jetuar në stilin që e zgjedh për të jetuar.

Ti je duke i përdorur aftësitë mendore që i ka secili. Ato janë të njëjtat aftësi mendore të përdorura nga Koperniku, Buddha dhe Morzeu. Mund ta kesh formuar shprehinë e të menduarit se njerëzit si këta janë të ndryshëm nga ti e unë. Por dua ta dish se dallimi i vetëm ndërmjet teje dhe tyre, apo kujtdo tjetër, është vetëm në pamje dhe në arritje. Të gjithë jetojmë në trupa të ndryshëm fizikë dhe të gjithë i përdorim aftësitë tona të qenësishme në mënyrë tjetër; por struktura jonë themelore është rrënjësisht e njëjtë.

Bile edhe Isa-Jezusi provoi t'i tregojë botës, ndërsa e bënte punën e tij të madhe para dymijë vitesh, se edhe ju jeni të aftë ta bëni atë që e bënte ai. Në fakt, ai shkoi një hap më larg duke thënë, "Ju jeni të aftë për gjëra edhe më të mëdha". Besoji, ai e thoshte të vërtetën. Njerëzit e vegjël do të thonë, kjo nuk është çka ka menduar ai. Por më lejo të të siguroj, kjo është saktësisht çka ka menduar ai. Nëse mund ta shohësh dhe ta besosh - mund ta bësh.

Napoleon Hill, në librin "Mendo dhe pasurohu" thekson se gjëja e vetme që e dallon Tomas Edisonin apo Henri Fordin nga njerëzit tjerë është këmbëngulja. Të dy këta njerëz të mëdhenj e kishin një imazh dhe nuk do ta lejonin askënd apo asgjë t'i zhbinte - ata ishin këmbëngulës. Njëri e ndriçoi botën, tjetri e vuri botën në rrota. Të dy, natyrisht, u shpërblyen me pasuri.

Paratë janë shpërblim për shërbimin e dhënë. Këta njerëz ofruan shërbim të pamasë për miliona individë dhe shpërblimi i tyre ishte në proporcion të drejtë me shërbimin e ofruar. Pra ndërtoje imazhin tënd të mirëqenies dhe ji këmbëngulës. Mënyra se si do të materializohet imazhi yt do të të tregohet.

Ndërtoje imazhin tash, mu aty ku je. Mos prit as ta kryesh këtë libër. Ndërtoje tash dhe le ta forcojnë faqet e ardhshme imazhin. Nuk ke nevojë as të provosh, thjesht leje një imazh të vetes tënde më të mirëqenishme të pluskojë në qendrën e vetëdijes tënde. Ai tashmë është këtu, prandaj lejoje të shfaqet.

Ndërsa e përfundon këtë kapitull, lëshoje librin dhe bëhu shumë i relaksuar. Le ta mbushë energjia krijuese vetëdijen tënde dhe pastaj jepi formë të imazhit të vetes në një gjendje shumë më të begatshme të jetës. Shihe veten tashmë në posedim të asaj që vetëm e ke ëndërruar. Bëhu jashtëzakonisht i vetëdijshëm për të vërtetën se qenia jote e plotë nuk është vetëm e mbushur, por edhe e rrethuar nga, substanca origjinale nga e cila ndërtohen të gjitha imazhet. Pra mos vazhdo thjesht të lexosh faqe për faqe pa vepruar sipas "sugjerimeve" që jam duke të t'i dhënë.

Gjeje kohën mu tash, në këtë minutë, ta ndërtosh imazhin në mendjen tënde të vetes tashmë në posedim të mirëqenies. Shkruaje një përshkrim të shkurtër të imazhit tënd në një letër, barte në xhep dhe lexoje çdo ditë, disa herë, derisa imazhi ta mbushë vetëdijen tënde.

Filloje deklarinimin tënd të shkruar me:

Jam kaq i, e lumtur. Tash e shoh veten me

LËSHOJE DËSHIRËN DHE LEJOJE ZOTIN

"Diçka e mrekullueshme po ndodh." John Kanary, The Personal Coach (Trajneri Personal)

Potenciali është gjithmonë gjithkund

Kuptoje këtë - gjithçka që e sheh në këtë univers, përfshirë edhe ty, është veçse shprehje e një fuqie të pafundme. Kjo fuqi rrjedh gjithmonë në dhe nëpër ty. Shkencëtarët do të të thonë se gjithçka është energji. Unë zgjedhi të them se gjithçka është Shpirt.

Lëshoje dëshirën dhe lejoje Zotin

Shekuj me radhë ka qenë një grup i zgjedhur i njerëzve që janë mendues të vërtetë. Këta individë gjithmonë e kanë ditur se është një fuqi që përhapet, depërton dhe i mbush ndërhapësit e universit, dhe se gjithçka që e sheh përreth teje është shprehje e asaj fuqie. Fuqia operon në mënyrë shumë precize, që përgjithësisht quhet ligj. Me fjalë tjera, gjithçka vjen nga një burim, dhe ajo fuqi burimore gjithmonë rrjedh dhe punon me dhe përmes individit - ky je ti. E formuluar pak më ndryshe, imazhi që e ke formuar mund të vijë te ti në rrafshin fizik të jetës (rezultatet e tua) vetëm në një mënyrë, dhe ajo mënyrë është Sipas Ligjit dhe përmes Besimit.

Çkado që e arrin në jetën tënde , do të jetë në proporcion të drejtë me:

- 1) intensitetin, dhe
- 2) këmbënguljen e besimit tënd.

Për ta përmbledhur - hapi i parë në procesin krijues është të relaksohesh dhe ta shohësh veten tashmë në posedim të të mirës që e do. (Ndërtoje imazhin.) Hapi i dytë është ta Lëshosh Dëshirën dhe ta Lejosh Zotin.

Poenta që dua të ta ngulis në kokë tash, është se megjithëse Shpirti është pikërisht esenca e qenies tënde, ai kurrë nuk do të lëvizë në formë apo në imazh, pa ndihmën tënde. Pra ata njerëz që ulen dhe s'bëjnë asgjë, duke thënë, "Zoti do të kujdeset për mua", vetëm sa po e mashtrojnë veten. Meqë është e vërtetë se Zoti iu ndihmon vetëm ata që së pari e

ndihmojnë veten, rrjedh se gjithmonë duhet ta bësh pjesën tënde për ta vënë në lëvizje procesin krijues. Gjithmonë duhet ta ndërtosh imazhin dhe ta dish në zemër se imazhi do të materializohet. Duhet ta shikosh Zotin si furnizues të madh të padukshëm që e përshkon çdo fije të qenies tënde dhe duhet ta kuptosh edhe këtë se posa ta formosh imazhin në mendjen tënde, Zoti do të nisët të punojë në Mënyrën e Përsosur të Zotit dhe do të të lëvizë në një vibracion krejtësisht të ri (d.m.th. do të fillosh të ndihesh ndryshe). Pra gjithmonë kujtoje, ndjenja e re që të përshkon është në të vërtetë Zoti duke punuar, dhe edhe pse ndonjëherë mund ta shprehësh ngazëllimin tënd duke thënë se ndihesh entuziast, kujtoje se fjala Entuziazëm është thjesht me prejardhje nga greqishtja e hershme - "en theos" - që domethënë në Zot.

Qëndrimi yt entuziast do të shkaktojë që të ndryshojnë veprimet e tua dhe do të fillosh të sillesh ndryshe. Për më tepër, jo vetëm që do të fillosh të sillesh ndryshe, por për shkak të vibracionit të ri në të cilin je, do të fillosh të gravitosh kah, dhe të tërheqësh kah vetja, njerëz të tjerë me mendje të ngjashme. Gjëra të çuditshme dhe të mrekullueshme do të fillojnë të të ndodhin dhe me asi rregulli sa që s'do të kesh fjalë ta shpjegosh e as ta kuptosh se çka po ndodh - pra "as mos u mundo". Thjesht kujtoje se është "Mënyra e Zotit" apo "Mënyra e Forcës Krijuese", dhe pranoje të mirën ndërsa vjen dhe prit më shumë nga ajo në të ardhmen.

Në sipërfaqe, mund të duket, kohë pas kohe, se gjërat nuk po shkojnë mirë dhe mund të fillosh të brengosesh se po shkon në drejtim të gabuar. Por më lejo të të siguroj, se kjo nuk do të ndodhë, përderisa e mban imazhin e të mirës që e dëshiron të rrënjosur vendosmërisht në mendjen tënde të nënvetëdijshme. Sepse nëse e bën këtë, do të vazhdosh të lëvizësh në drejtimin e vetëm në të cilin mund të lëvizësh, për të arritur aty ku dëshiron të shkosh.

Mos e detyro të ndodhë

Nuk duhet të ketë kurrfarë detyrimi të shoqëruar me manifestimin e imazhit tënd, sepse "Detyrimi mohan". Tentimi për ta bërë në mënyrën tënde, duke i detyruar gjërat që të ndodhin, nuk është patjetër mënyra e Zotit. Prandaj, mësohu ta ndjekësh zërin e qetë përbrenda që flet në ndjenja e jo në fjalë; ndiqe atë që "e dëgjon" brenda, e jo atë që mund të të thonë të tjerët ta bësh. Ji i vetëdijshëm se zëri i qetë përbrenda të thotë shpesh gjëra që shkojnë kundër mënyrës se si i jetojnë jetët shumica e njerëzve. Por mos u merakos shumë për këtë. Shumica e liderëve më të mëdhenj të botës janë konsideruar heretikë nga të tjerët, thjesht sepse kanë zgjedhur të "marshojnë me ritmin e një timpanisti tjetër!" Këta individë e kanë ndjekur zërin e qetë brenda tyre, dhe nuk i kanë bërë gjërat që janë

konsideruar si të modës në atë kohë. Le të zhytet imazhi yt thellë në thesarin e mendjes tënde të nënvetëdijshme. Lëre veten të përfshihet plotësisht dhe emocionalisht me Imazhin tënd, sepse duke e bërë këtë je "duke e lëshuar dëshirën dhe duke e lejuar Zotin". Kuptoje, për më tepër, se nëse lëkundesh - për çfarëdo arsye - dhe shkon sipas mënyrës tënde, në minutën që e pranon gabimin tënd, dhe e ripohon imazhin tënd, Shpirti do të vazhdojë aty ku e ka lënë atëherë kur ke zgjedhur ta marrësh kontrollin. Pastaj do të kthehesh menjëherë në vibracionin e duhur dhe në rrugën korrekte, që çon në sukses në jetë.

Përcilli udhëzimet vijuese deri në shkronjën e fundit.

Principi i parë

Relaksohu dhe shihe veten tashmë në posedim të të mirës që e dëshiron.

Principi i dytë

Lëshoje dëshirën dhe Lejoje Zotin!

PRIT BEGATI

"Mendja është magnet i fuqishëm dhe si e tillë, ajo tërheq çkado që i përgjigjet gjendjes së saj sunduese. Pritja dikton se çfarë do të jetë ajo gjendje sunduese dhe prandaj e qeveris se çka i përgjigjet mendjes dhe tërhiqet në jetën tënde. Pritja mund të jetë ose bekim ose mallkim por në të dy rastet është pa dyshim një nga forcat më të fuqishme të padukshme në jetën tënde."

John Kanary, folës publik, autor, ndërmarrës

Dy faktorët përcaktues për t'i arritur rezultatet që i dëshiron janë:

- 1) dëshira, dhe
- 2) pritja.

Dëshira pa pritje është asgjë më shumë se sa fantazim i kotë, dhe meqë shumica dërmuese e njerëzve e duan pozitiven por e presin negativin, ata rrallë e arrijnë atë që e synojnë.

Në librin e tij të mrekullueshëm "Shkenca e të pasuruarit", autori, Wallace D. Wattles, na e ka dhënë një definicion të shkëlqyeshëm të dëshirës. Ai tha: "Dëshira është përpjekja e mundësisë së pashprehur përbrenda që kërkon shprehje përjashtë përmes veprimit tënd."

Me fjalë tjera, ideali, ëndrra apo qëllimi yt - kjo pasuri që dëshiron ta shohësh të materializuar - mund të bëhet dëshirë vetëm pasi të jetë mbjellë si duhet në mendjen e nënvetëdijshme. Mirëpo, posa të jetë stabilizuar mirë dëshira jote, është qëndrimi pritës ai që e siguron që qëllimi apo ëndrra jote nuk çrrënjohet apo zëvendësohet me ndonjë ide kundërshtuese apo garuese.

Duhet ta arrish fazën në zhvillimin tënd mendor ku jo vetëm që beson se imazhi yt i pasurisë materiale do të manifestohet në formë, por në të vërtetë e di se do të manifestohet.

Në këtë pikë do të fillosh të presësh ta pranosh shprehjen fizike të imazhit tënd të pasurisë. Askush dhe asgjë nuk do të mund të të bëjë të shohësh në mendje asgjë pos tij. Gjithmonë kujtoje, e vërteta nuk është gjithmonë në pamjen e gjërave.

Dëshira jote është fuqia motorike që do të të lëvizë kah ëndrra jote dhe pritja është forca tërheqëse që do ta lëvizë ëndrrën tënde kah ti. Pra shihe veten duke lëvizur drejt pasurisë që e vizualizon dhe shihe pasurinë që e vizualizon duke u tërhequr te ti. Dije se do të vish në kontakt me pasurinë që po lëviz kah ti, dhe në kohën e duhur. Askush nuk e di se çfarë periudhe e kohës duhet të kalojë, prandaj mos ji i padurueshëm nëse nuk materializohet "brenda natës". Krejt çka dimë me siguri është se duhet të kalojë një periudhë e caktuar dhe periudha e kohës që duhet ta marrë imazhi yt për t'u materializuar qeveriset nga ligji i ngjizjes. Ligji i Ngjizjes thotë që është një periudhë e ngjizjes apo e inkubimit për manifestimin e të gjitha farave, dhe, mos e huq këtë, imazhi i pasurisë që e zgjedh ta ndërtosh në ekranin e mendjes tënde të vetëdijshme dhe pastaj i dorëzuar te mendja e nënvetëdijshme është farë; dhe është duke u rritur në formë fizike, në tokën më pjellore që mund ta konceptosh ndonjëherë.

Nuk nevojitet, në këtë pikë, që dikush tjetër ta shohë këtë pasuri të re. Bile as nuk nevojitet që dikush tjetër të besojë se do ta pranosh. E vetmja gjë nevojitet është që ti ta shohësh dhe ta besosh. E sheh, premisa mbi të cilën Napoleon Hill e ndërtoi punën e jetës së vet është absolutisht e vërtetë - çkado që mendja mund ta konceptojë dhe ta besojë, do ta arrijë. E shprehur ndryshe, "Ashtu si mendon një person në zemër, i tillë është." (Grekët e vjetër iu kanë referuar mendjes së nënvetëdijshme si zemra.) Vëreje se mendja jote e nënvetëdijshme nuk mund ta ndryshojë imazhin tënd më shumë se që mundet një pasqyrë e rregullt të ta reflektojë një imazh ndryshe nga objekti që je duke ia mbajtur përpara. Por mbaje në mend, si mendon ashtu je, dhe kjo nuk e ka kuptimin ashtu si ju thua njerëzve se mendon apo ashtu si do të doje të besojë bota se mendon; kjo domethënë mendimet tua më të thella, që i kontrollojnë vetëm ti, e dinë të vërtetën. Këtë e pret, pra këtë e tërheq dhe këtë do ta pranosh përfundimisht!

Prit, me tërë vetëdijen tënde, ta pranosh të mirën tënde në botën tënde materiale - "Ti mendon në fshehtësi, dhe ajo ndodh, rrethina është asgjë tjetër pos xhami i pasqyrës sate." James Allen i ka shkruar këto fjalë para një shekulli, por ato janë ende të vërteta sot dhe do të mbesin gjithmonë të vërteta në të ardhmen. Pra programoje "kompjuterin tënd personal" për të pritur rezultate të mira dhe kjo është pikërisht ajo që do ta pranosh.

Shumë njerëz sot e jetojnë tërë jetën në bazën "ta shohësh është ta besosh". Domethënë, imazhet e vetme me të cilat përfshihen emocionalisht janë ato që mund t'i shquajnë me shqisat e tyre fizike. Por individët e "vizionit" ("të pamurit") të vërtetë, nëpër vite, gjithmonë e kanë ditur se principi thelbësor është, "Ajo që e sheh është ajo që e merr." E shprehur disi ndryshe, kjo domethënë se imazhet në mendjet e njerëzve realisht i paraprijnë imazheve konkrete që përhapen në botën tonë materiale. Prandaj, gjithmonë duhet të jesh i vetëdijshëm për faktin se bota fascinuese fizike që e shohim para nesh, me të gjitha komoditetet për të na bërë jetën më të rehatshme, është ndërtuar kryesisht nga ndërtuesit e imazheve - meshkujt e femrat e vizionit që e dinin se çka mund të bënin dhe "pritnin" që gjithçka tjetër "do të bijë në vend", pavarësisht se çka mund të thonë kritikët e tyre.

Janë tre hapa të sigurt për arritjen e mirëqenies në të gjitha fushat e jetës tënde:

- Numër një, ndërtoje imazhin në mendjen tënde.
- Numër dy, dorëzoja Shpirtit (Lëshoje dëshirën dhe Lejoje Zotin).
- Numër tre, prit me zemrën dhe shpirtin tënd se Shpirti do të të shpërblejë singërisht për besimin tënd.

Prit Begati

LIGJI I LËKUNDJES DHE I TËRHEQJES

Mendimet janë gjëra

E di vërtet se mendimet janë gjëra;
Ato janë të pajisura me trupa
dhe frymëmarrje dhe krahë;
Dhe se i dërgojmë ato tutje për ta mbushur
botën me rezultate të mira, apo të liga.
Ajo që e quajmë mendimi ynë sekret
Nxiton deri te pika më e largët e tokës,
Duke i lënë bekimet apo mjerimet e veta
Si gjurmë prapa teksa shkon.
Ne e ndërtojmë të ardhmen tonë, mendim pas mendimi.
Për të mirë apo për të lig, edhe pse s'e dimë.
Se kështu universi është kurdisur.
Mendimi është emër tjetër për kështet;
Zgjedhe pra fatin tënd dhe prit,
Sepse dashuria sjell dashuri dhe urrejtja sjell urrejtje.

(Henry Van Dyke)

"Çfarëdo ideje që mbahet në mendje, të cilës ose i frikësohemi ose e nderojmë, do të fillojë menjëherë ta veshë veten në format fizike më të volitshme dhe më të përshtatshme të mundshme."

Andrew Carnegie

"Ligji i Tërheqjes" është principi thelbësor që e qeveris nivelin e mirëqenies tënde personale. Mirëpo, për të të ndihmuar ta arrish një zotërim solid të këtij koncepti, do të nevojitet të përqendrohemi shkurtimisht në një ligj tjetër, domethënë "Ligjin e lëkundjes".

Gjithçka është Energji, Gjithçka Lëkundet

Që ti ta kesh një vetëdije më të mirë se si do ta marrësh kontrollin ndaj rezultateve tua (d.m.th. ta kuptosh më mirë se si dhe pse mendimet dhe gjërat vijnë në jetën tënde ashtu si vijnë), duhet të kthehesh te premisa: gjithçka lëkundet dhe asgjë nuk rri e qetë. Mirëpo duke u mbështetur në Vullnetin tonë Të Lirë dhe shumë faktorë tjerë mendorë në mendjen tënde të mahnitshme, e ke aftësinë Bashkë-Krijuese që t'i shkaktosh ndryshimet lëkundëse të ndodhin sipas kërkesës tënde në jetën tënde. Shkaku për mungesën tonë të aftësisë për ta ushtruar këtë fuqi të mahnitshme për të mirë nuk është asgjë tjetër pos injoranca jonë për Ligjin e Lëkundjes.

Gjithçka është shprehje e gjësë së njëjtë

Gjithçka në tërë këtë univers është e lidhur me gjithçka tjetër në tërë këtë univers, përmes Ligjit të Lëkundjes. Ashtu sikur ngjyrat në ylber janë të lidhura ashtu që nuk mund të thuash se ku ndalet një ngjyrë dhe fillon tjetra, ashtu nuk mund ta dallosh se ku fillon një "gjë" dhe ku ndalet tjetra. Gjithçka në këtë univers është e lidhur me gjithçka tjetër në këtë univers, ashtu sikurse uji që vlon që është i lidhur me avullin në të cilin shndërrohet, dhe avulli lidhet me eterin apo ajrin në të cilin ndryshohet. Edhe ti je i lidhur me gjithçka në univers. A mund ta shohësh me sy të lirë apo jo është e parëndësishme. Dallimi i vetëm fizik që ekziston ndërmjet një gjëje dhe një tjetre, lidhet me dendësinë apo amplitudën (gjerësinë) e lëkundjes së tyre. Prandaj, posa të zgjedhni mendime të caktuara, qelizat e tua të trurit ndikohen. Këto qeliza lëkunden dhe dërgojnë valë elektromagnetike. Kur përqendrohesh në këto mendime, ti e rrit amplitudën e lëkundjes së këtyre qelizave, dhe valët elektrike, si efekt, bëhen shumë më të fuqishme. Dije se ti je ai që po i nis këto valë elektrike dhe dije se po e përcakton edhe dendësinë e tyre përmes vullnetit tënd të lirë. Duhet edhe ta dish se meqë je duke i nisur këto valë elektrike, e tërë qenia jote po vendoset në atë lëkundje të caktuar.

Dy objekte mund të jenë të lëndëve dhe formave krejtësisht të ndryshme, dhe prapë të jenë në Rezonancë. Kjo është për shkak të faktit se fushat e tyre magnetike thelbësore janë të njëjta, sepse janë brenda sferës së njëjtë të lëvizjes relative. (Mbaje në mend se rezonanca është faktor që e qeveris shndërrimin e vibrimeve.) Kur e mban imazhin e qëllimit tënd në ekranin e mendjes tënde, në kohën e tashme, ti po lëkundesh në harmoni (në rezonancë) me çdo grimcë të energjisë të nevojshme për manifestimin e imazhit tënd në planin fizik. Duke e mbajtur atë imazh, ato grimca të energjisë po lëvizin kah ti (tërheqja) dhe ti po lëviz kah to - sepse ky është ligji.

Të gjitha gjërat janë thjesht manifestime të energjisë apo të Shpirtit.

Ky është univers i rregullt; asgjë nuk ndodh rastësisht. Imazhet që i mbjell në mendjen tënde mahnitëse do ta vendosin menjëherë një forcë tërheqëse, që i qeveris rezultatet e tua në jetë. Por duhet ta mbash në mend se nëse imazhi yt luhet vazhdimisht, vazhdimisht do të rrites në diçka tjetër dhe kjo e vë në lëvizje një proces shumë kaotik. Fatkeqësisht, ata individë që janë të pavetëdijshëm për këto ligje shumë ekzakte mbjellin një minutë imazhe të bollëkut në mendjen e tyre dhe pastaj imazhe të skamjes në minutën tjetër. Ata vazhdimisht i "ndryshojnë" lëkundjet, kështu që tërheqin gjëra të mira një minutë pastaj gjëra të këqija minutën tjetër. E vërteta pikëlluese është se shumica dërmuese e njerëzve e kalojnë tërë jetën e vet duke u lëkundur ndërmjet këtyre dy pozitave të skajshme, me efektin rezultues që jetët e tyre bëhen të parregullta dhe kaotike.

Edhe pse është e vërtetë se gjithçka që do ta duash ndonjëherë tashmë është këtu, varet nga ti të biesh në harmoni me të. Qartas, kurrë nuk do të biesh në harmoni me mirëqenien, nëse insiston në mbajtjen e imazheve të mungesës dhe të kufizimit në depon e mendjes tënde mahnitëse. Meqë gjithmonë je i magnetizuar drejt diçkaje, rrjedh se kurrë nuk mund të jetë gabimi i dikujt tjetër, kur diçka vjen në jetën tënde që me sa duket nuk e dëshiron. Kuptoje se ti e ke porositur dhe se po të dorëzohet, pikërisht në kohë!

Ndihmimi i të tjerëve të ndihen më mirë

Trupi i njeriut, përfshirë edhe trurin, është instrument elektrik me fuqi të madhe. Prandaj, ti je "stacion transmetues" i vërtetë, ndaj njerëzve tjerë. Kur është kryer "kapja e stacionit" ndërmjet teje dhe tij, apo kur është krijuar personaliteti kompozit ndërmjet teje dhe personit tjetër, personi tjetër e pranon dhe bëhet i vetëdijshëm për mendimin lëkundës që po transmetohet nga ti.

Nën Ligjin e Transmetimit dhe të Shndërrimit të Përhershëm të Energjisë, personi tjetër, meqë është potencial i ulët i energjisë, e merr këtë energji të shtuar që po dërgohet nga ti. Dhe, si bateri e dobët, personi tjetër rimbushet, bëhet më energjik, dhe më pozitiv si rezultat i kontaktit të tij me ty.

Procesi i transmetimit të energjisë ndërmjet teje dhe personit tjetër është saktësisht i njëjtë sikur procesi që ndodh ndërmjet stacionit transmetues dhe radios. Domethënë, ligjet që janë identike në natyrë, i qeverisin të dy fenomenet.

NDËRMARRËSIT E RREZIKUT

Ditët e mbrojtjes së "posedimeve" dhe "pozitive" aktuale kanë mbaruar përgjithmonë. Prandaj, nga kjo ditë e tutje, kurrë nuk do të kesh nevojë të shqetësohesh me çështje të tilla problematike siç është "mbajtja e punës tënde aktuale", apo "mbajtja e standardit tënd aktual të jetesës". Në vend të kësaj, do t'i vësh gjërat që "mund të shkojnë keq" në mbrojtje, dhe do t'i vësh gjërat që "duhet të shkojnë si duhet", në formacion të gatshëm për sulm. Që nga sot, ti je ndërmarrës dinamik i rrezikut, i vrullshëm, sytë e të cilit gjithmonë janë të kthyer kah fuqitë dhe asetet e tua, e jo kah dobësitë dhe detyrimet ndaj të tjerëve. Tani e tutje, do të zgjohesh në mëngjes, duke menduar vetëm për "mënyrat për t'i bërë gjërat që dëshiron t'i bësh", e jo të zgjohesh duke menduar për "të gjitha arsyet se pse nuk mund t'i bësh këto gjëra".

Që nga sot, do të mendosh në mënyrë të përsëritur për shumë arritje që do t'i bësh në të ardhmen, që janë shumë më të larta ndaj gjithçkaje që e ke bërë ndonjëherë në të kaluarën. Qartas, këto janë rezultatet që mund të arrihen vetëm nëse së pari je i gatshëm të ndërmarresh një lloj rreziku. Më beso, posa ta ndërmarresh këtë proces, nuk do të shkojë gjatë dhe do të fillosh të fitosh - dhe në sasi të madhe bile.

Para se të nisësh në këtë rrugë ngazëlluese të ndërmarrjes së rrezikut, duhet ta mbash në mend të mos e humbësh kurrë nga pamja faktin se të bëhesh ndërmarrës i rrezikut nuk domethënë të bëhesh individ i papërgjegjshëm. Nëse vërtet e mendon mirë këtë, do ta kuptosh se këto dy koncepte e përjashtojnë njëri-tjetrin. Sepse të bëhesh ndërmarrës i rrezikut domethënë të veprosh me guxim, e të veprosh me guxim është në masë të konsiderueshme ndryshe nga të vepruarit pa mend (që është mënyra se si vepron një person kur sillet në mënyrë të papërgjegjshme).

TEHU I BRISKUT TË RROJËS

Je vetëm një centimetër... një hap... një ide... afër kthesës në bulevardin e bukurisë në jetën tënde.

Shpesh është thënë se vija që e ndan fitoren nga humbjen është aq e hollë sa tehu i briskut të rrojës - dhe është. (Po flas për fitoren në mënyrë të madhe dhe në të gjitha fushat e jetës tënde.)

Një person "gati" e fillon një projekt, tjetri e fillon atë. Një individ "pothuajse" e kryen një punë, tjetri e kryen atë. Një person e sheh një shans, tjetri vepron në të. Një student "është afër" ta kalojë provimin, tjetri e kalon - dhe edhe pse dallimi në notat e tyre mund të jetë një për qind, është ajo pikë që e bën tërë ndryshimin.

Tash, konsideroje dallimin mahnitës që do ta krijoje në jetën tënde nëse do ta adoptoje qëndrimin mendor të tehut. Për shembull, nëse je person që punon në shitje dhe aktualisht i shet vetëm tri njësi në javë, çfarë do të ishin pasojat për ty nëse vendos ta bësh një shitje shtesë në javë, përmes aplikimit të vetëdijshëm të konceptit të përpjekjes së dytë? Epo, në baza javore, mund të mos duket të jetë dallim i madh. Mirëpo, e shikuar nëpër kornizë kohore të një karriere të tërë, në fakt do të dilte sasi e mirë mbi 2 mijë shitje shtesë. Për më tepër, nga pikëpamja monetare, do të nënkuptonte se do të pranoje të ardhura shtesë të dhjetë viteve përgjatë një karriere dyzet-vjeçare. Po, ajo shitje e vetme do të ishte dallimi i Tehut të Briskut, që do të të katapultonte në "ligat e mëdha" në karrierën tënde të zgjedhur.

Ndërsa vetëdija jote bëhet gjithnjë e më e madhe në lidhje me konceptin e "Tehut të Briskut", do të befasoresh me numrin e shembujve të tillë që i has çdo ditë. Si rast në këtë pikë, vetëm konsideroje se sa më mirë ndihesh ndaj një shitoreje të caktuar, ku kasieri buzëqesh dhe "të falënderon për biznesin tënd," dhe pastaj kërkon që të kthehesh "së shpejti", krahasuar me një shitore ku të përshëndesin me qëndrim të sertë, "Epo, a do të blesh diçka apo jo?".

Mbase faktori që do të të katapultojë në "ligat e mëdha", që do t'i shumëfishojë të ardhurat tua nga një pikëpamje materiale si dhe psikike, do të jetë aftësia jote të këmbëngulësh. Pra herën tjetër që nisesh të bësh diçka dhe "shkon vështirë", thjesht kujtoje se dallimi i Tehut të Briskut për ty mund të jetë aftësia jote për të këmbëngulur. Thjesht provoje edhe një herë - me entuziazëm - dhe mund t'i shohësh arritjet e tua të kërcejnë nga shumë të zakonshme, në shumë të jashtëzakonshme!

A mendon se individët jashtëzakonisht të suksesshëm janë tridhjetë apo dyzet herë më të mirë se kolegët e vet? - natyrisht se jo! Ata me gjasë janë vetëm tre apo katër për qind më efektivë. Por në terma të të ardhurave vjetore, absolutisht nuk ka krahasim. Çka e bën dallimin për ta? Mbase ata e planifikojnë ditën e vet, ndërsa të tjerët jo; apo mbase kanë ushtruar për një orë, ndërsa të tjerët jo. Sidoqoftë, çkado që kanë bërë, mund të jesh i sigurt se dallimi ishte aq i hollë sa Tehu i Briskut!

Tash ndale leximin, ulu, relaksohu, dhe mendo, vërtet mendo - çka ka në jetën tënde që do ta bëjë dallimin e Tehut të Briskut për ty? A e di se çka është?

Mirë - atëherë bëje tash!

MOS MENDO TEPRAPA

"Të mos shikojmë prapa me zemërim as përpara me frikë po përreth nesh me vetëdije."

Leland Val Van De Wall

Kurrë nuk do të arrish masë substanciale të pasurisë materiale nëse insiston në të jetuarit e jetës tënde sikur të ishe duke shikuar prapa përmes pasqyrës së automobilit. Megjithatë, ky duket të jetë gabim shumë i shpeshtë të cilin shumë njerëz e kanë kthyer në shprehje të dëmshme. Me fjalë tjera, shumë nga ne i kalojnë shumicën e momenteve tona të tashme, "duke u endur mentalisht", në zonën kohore të të kaluarës së vdekur dhe që-duhet-të-harrohet.

Pra, pavarësisht nga rrethanat aktuale në të cilat e gjen veten, kuptoje qartë se nëse mund ta ndërtosh imazhin e diçkaje të re në mendjen tënde, diçkaje që i lë shumë larg prapa të gjitha ato që kanë ndodhur deri tash, ti e ke aftësinë ta realizosh atë rezultat në botën fizike. Nuk mund të qartësohet më shumë, se të gjithë ne jemi "Lindur të Pasur", në sensin e të pasurit të një potenciali madhështor të dhënë nga Zoti, të cilin ia kemi borxh vetes ta kultivojmë.

Mbaje në mend, nëse mund ta shohim veten duke e bërë, qenë, apo pasur diçka, në ekranin e mendjes tonë të vetëdijshme, atëherë mund ta bëjmë, jemi, apo ta kemi edhe në planin fizik të jetës. E sheh, fjala e urtë është e vërtetë: "Ajo që e sheh, është ajo që e merr". Prandaj, gjithmonë shiko përpara në të ardhmen e shndritshme që shtrihet pikërisht para vendit ku je aktualisht.

Më lejo ta qartësoj që nuk po i referohem, në këtë kontekst, gjërave që mund t'i "shohësh" vërtet, me shqisën tënde të "të pamurit" (d.m.th. të shikosh në atë që ishte apo që është). Në vend të kësaj, po i referohem syrit tënd krijues që ta mundëson ta shohësh se çka mund të jetë. Syri i brendshëm krijues është ajo pjesë madhështore e personalitetit tënd që të lejon të shohësh në arritje të gjera të "botës krijuese, jofizike". (Kjo është fusha ku nis, zë fill tërë jeta.)

Jeni lindur të pasur

E kaluara, në të kundërtën, është vendi ku tërë jeta mbaron. Por, fatkeqësisht, është edhe vendi ku 95% e njerëzve e kalojnë 95% të kohës së vet (që është, pikëllueshëm, edhe jeta e tyre).

Prandaj, shiko lart, shiko përpara dhe formoje imazhin e jetës që zgjedh ta jetosh, pastaj gjithçka që e prek apo me të cilën kontakton do të rritet dhe do të zgjerohet dhe do ta shprehë veten në mënyrë gjithnjë e më të madhe.

LIGJI VAKUMOR I MIRËQENIES

Natyra e ka absolutisht neveri vakumin.

Në shumë raste gjatë seminareve të mija, e kam diskutuar këtë ligj. Ua kam shpjeguar audiencave, se edhe pse çdokush dëshiron të ketë rroba të reja, shumica e njerëzve nuk kanë hapësirë në dollapët e vet për të varur rroba të reja. Në fakt, kur var diçka në dollapin tënd, me gjasë duhet t'i shtysh rrobat tjera anash, për ta zënë edhe një varëse në shufër. Mirëpo, ironia është se shumicën e rrobave që po varen në dollapin tënd, me gjasë nuk do t'i veshësh fare!

Ky "ligj" vlen jo vetëm në botën tonë fizike, por edhe në domenin tonë mendor. Pra kuptoje, se sa herë që duam të ushqejmë ide të reja, duhet së pari të jemi të gatshëm "t'i lëshojmë", apo t'i sfidojmë disa nga idetë tona të vjetra.

Pse mbahemi kaq fuqishëm me të idetë e vjetra apo gjërat e vjetra? Sepse na mungon besimi në aftësinë tonë për të siguruar ide të reja dhe gjëra të reja. Kjo, natyrisht, çon në një gjendje të pasigurisë, që buron, në rrënjë, nga një paaftësi ta kuptosh se kush, dhe çka, je. Dhe, një mungesë e vetëdijes të relacionit tënd të vërtetë me fuqinë e pafundme gjithmonë do të të lërë me imazh të shtrembëruar të vetes.

Prandaj, duhet ta arrish pikën ku e kupton se "vetja jote e vërtetë" nuk njeh kufij; se në të vërtetë, je plotësisht i aftë të kesh, të bësh, apo të jesh, praktikisht gjithçka që dëshiron të jesh.

Zoti kurrë nuk e shpreh Vetën ndryshe pos në mënyrë të përkryer. Prandaj, çfarëdo jopërkryeshmërie që ekziston, është gjithmonë rezultat i mënyrave tona individuale apo kolektive të të menduarit. Meqë kjo është e vërtetë, nuk ke nevojë të kapesësh pas asgjëje, "për shkak të frikës së humbjes së saj." Në fakt, e vërteta është, se kurrë nuk do të shijosh diçka pas të cilës duhet të kapesësh, sepse liria është absolutisht e nevojshme në të gjitha fushat negative të jetës tënde, nëse dëshiron të rritesësh në qenie të madhe njerëzore për të cilën je plotësisht i aftë të bëhesh një ditë. E thënë pak më ndryshe, mund të themi se energjia duhet të rrjedhë përmes teje lirisht pa pengesa, nëse dëshiron ta arrish të mirën që e dëshiron.

PËRFUNDIM

Secili kapitull në këtë libër theksoi koncepte të ndryshme, që duhet të fillosh t'i përdorësh po të duash t'i shijosh përfitimet që mund të dalin thjesht duke e lejuar që kjo fuqi të rrjedhë lirisht nëpër ty. Tash e ke lexuar tërë librin. Do të doja të sugjeroj që të kthehesh në fillim të librit, për t'i krahasuar rezultatet që je duke i marrë aktualisht në jetën tënde, me rezultatet që do të mund t'i merrje, aty ku do ta përdorje si duhet secilën ide. Studioje secilin kapitull shumë seriozisht - por në një gjendje të relaksuar - dhe vazhdo të vepros mbi secilën ide deri sa të bëhet pjesë e strukturës së personalitetit tënd.

Mbaje në mend, pavarësisht se si mund të të duken rezultatet e jetës tënde aktualisht, ju vërtet "Jeni Lindur të Pasur".

"Dhurata e Zotit për ty

është më shumë talent dhe aftësi

se sa që do të mund të përdorësh ndonjëherë

gjatë tërë jetës tënde.

Dhurata jote për Zotin

është ta zhvillosh dhe ta shfrytëzosh

sa më shumë që mundesh atë talent dhe atë aftësi,

në këtë jetë."

Steve Bow

FILLIMI

NJË DHE I VETMI TI

Çdo fije e veçantë e barit,

Dhe çdo fluskë e borës -

Është vetëm pak më ndryshe...

Nuk ka dy të njëjta, e di

Që nga diçka e vogël, si kokrrat e rërës,

Deri te secili yll gjigant

Të gjitha janë bërë duke e pasur KËTË në mendje:

Të jenë pikërisht çka janë!

Sa e pamend pra, të imitosh -

Sa e padobishme të shtiresh!

Meqë secili nga ne vjen nga një MENDJE

Idetë e të cilës nuk mbarojnë kurrë.

Do të jetë vetëm NJË si UNË

Të tregojë se çka mund të bëj -

Dhe prandaj edhe ti duhet të ndihesh krenar

Është vetëm NJË si TI.

Këtu fillon çdo gjë

Me ty, o qenie e mrekullueshme

e pakufizuar njerëzore.

(James T. Moore)

PUBLIKIME TJERA

Të gjitha publikimet |(|:) mund t'i shkarkoni falas nga web-faqet:

<http://sites.google.com/site/kalabuli/jetes%C3%AB>

<http://sa-kra.ch/>

<http://www.syri3.com/>

Faqja në Facebook: |(|:) Publikimet RB

<http://sites.google.com/site/kalabuli/>

Po ashtu, ato mund t'i shkarkoni direkt nga linqet e mëposhtme.

Të lehta

- [Leksiku me afirmime pozitive](#) është lojë e përpiluar dhe e programuar nga Artan Bunjaku. Programi e zgjedh një afirmim pozitiv dhe ju duhet t'ia qëlloni se cili është ai duke e zbuluar shkronjë për shkronjë. Kjo është një mënyrë e shkëlqyeshme e metabolizimit të të vërtetave pozitive përmes lojës.
- [Zhvillimi i katër inteligjencave/zotësive](#) është udhërrëfyes praktik për zhvillimin e të katër aspekteve njerëzore që të bëjnë njeri të plotë. Nxjerrë nga Zakoni i 8të i Stephen Covey-t, ky është publikim interesant për çdokë.
- [Disciplina e BL \(Bëj Lehtë\)](#) është një shkrim atraktiv për mënyrën e lehtë të bërjes së gjërave dhe për përdorimin e energjisë e përpjekjeve optimale për realizim.
- [Lumturia dhe Pasuria](#) mund t'i ndihmojë cilitdo, që po lufton me paratë, për ta gjetë një rrugë për jetë më të mirë financiare.
- [Dashuria në distancë](#) flet për sfidat e mbajtjes së lidhjes romantike në distancë.
- [Stresi në punë](#) përmban këshilla për menaxhimin e stresit në ambientin e punës
- [Meditimi i lehtë](#) është një artikull hyrës për meditimin që e përshkruan një teknikë krejt të thjeshtë.

Të mesme

- [Ndieje mirënjohjen](#). Secili përjetim i mundur është këtu. Dashuria. Shëndeti. Suksesi. Urtia. Gjithçka. E tëra është brenda Oqeanit dhe në dispozicion kur ti hapesh dhe e lejon atë brenda. Jeta është absolutisht e mirësjellshme në lidhje me këtë dhe nuk do të imponohet kurrë. Jeta nuk do të të detyrojë kurrë të kesh më shumë lumturi se sa je duke dashur ta shijosh.
- [Shtatë Zakonet e Njerëzve me Efektivitet të Lartë](#) është pasqyrë e shkëlqyeshme e praktikave individuale dhe ndërpersonale që do ta bëjnë çdo individ dëgjues, nxënës, partner, dhe lider më efektiv. Ai i sugjeron disa korniza të shkëlqyeshme për ta avancuar performansën personale.
- [Zakoni i 8të](#) - Depërtimi në nivelet më të larta të motivimit njerëzor kërkon model të ri mendor, grup të ri të shkathtësive - zakon të ri. Zakoni i 8të i Stephen Covey-t është hartë për të të ndihmuar ta gjesh përmbushjen dhe ngazëllimin tënd ditor.
- [Esenca e dijes nga Sekreti](#) e përmban thelbin e librit "Sekreti" të Rhonda Byrne: Ligji i Tërheqjes në praktikë.
- [Mirënjohja dhe Falënderimi](#) është një doracak praktik për energjinë pozitive që e ka në qendër shprehjen e mirënjohjes për të mirat që i kemi.
- [11 ligjet e harruara](#) është një zgjerim i konceptit të Ligjit të Tërheqjes; ligje të mendjes të analizuara e të formuluar bukur nga Bob Proctor.
- [Ashtu si mendon njeriu](#) është ese letrare e James Allen e vitit 1902, një hyrje e bukur në shkencën e të menduarit dhe të ndjenjave. "Shpirti e tërheq atë të cilën e strehon fshehtas; atë që e do, dhe po ashtu edhe atë të cilës i frikësohet; ai e arrin lartësinë e aspiratave të tij më të dashura; ai bie në nivelin e dëshirave të tij të papastra, dhe rrethanat janë mjetet me të cilat shpirti e pranon të veten."
- [E vetmja frikë është frika vetë](#) është fjalimi i presidentit amerikan në kohën e depresionit të thellë. Ka shumë paralele ndërmjet gjendjes së popullit amerikan më 1932 dhe popullit tonë tash.

Të avansuara

- [Shtatë ligjet shpirtërore të suksesit](#), i miratuar dhe i rekomanduar nga Daut Demaku, e shpjegon idenë se sukcesi personal nuk është rezultat i punës së mundimshme, planeve precize apo ambicies së furishme, por i kuptimit të natyrës sonë themelore si qenie njerëzore dhe si t'i ndjekim ligjet e natyrës. Kur i kuptojmë dhe i aplikojmë këto ligje në jetën tonë, çdo gjë që dëshirojmë mund të krijohet, "sepse ligjet e njëjta që i përdor natyra për ta krijuar një pyll, një yll, apo një trup njeriu mund ta shkaktojnë edhe përmbushjen e dëshirave tona më të thella".
- [Mbështetja në vetveten](#) e përmban deklarin më të plotë të njëres nga temat kryesore të Emersonit, nevojën për secilin individ që ta lërë konformitetin dhe konsistencën false, dhe t'i përcjellë instinktët dhe idetë e veta.
- [Hapat A deri në Z për krijimin e begatisë](#) është material i shkëlqyeshëm për studim ditor apo dëgjim. Është thelbi i koncepteve të Dipak Çoprës që i shpjegon me fjalë të thjeshta ligjet shpirtërore të suksesit. "Creating Affluence" (Krijimi i begatisë) është distiluar në "The seven spiritual laws of success" (Shtatë ligjet shpirtërore të suksesit).